


# KLARA KODRA

VJERSHA DHE POEMA



# BUZEQESHJE

8JH - 1  
K - 78

KLARA KODRA

891.983 - 1

S

# BUZEQESHJE

(VJERSHA DHE POEMA)

~~53184~~  
~~13088~~  
SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»  
AS TUT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

2012.

## ZJARRE DHE VRULLE

*Në mos qoftë rinia veçse një kupë e zjarrtë,  
këtë kupë le ta pinë — për shekullin e ri!*

## DUKE KËRKUAR DRITËN

*Fuat Çelës*

Njeriu lind me etjen për dritë.  
Mbyll sytë me etjen për dritë.  
A ka dhimbje më të madhe se të jesh rrëthuar  
nga errësira?

---

Dhe ishin kaq afër, kaq afër,  
profil i rreptë i maleve,  
qielli plot rreze,  
toka nënë  
dhe shokët që i shfaqnin asaj dashurinë e  
ashpër.

Midis tyre dhe teje  
një perde e zezë.  
Mos vallë kurrë s'do t'i rrokje dot?  
Kjo botë e ndritur t'ish për ty pa ngjyrë?  
Me sytë pa dritë,  
ku s'u panë lot

vështrove drejt jetën në fytyrë.  
Shkove drejt dritës...  
Rinia digjte në gjoks,  
dhe s'u pengove  
nga gurët e nga fjalët.  
Disa i mbulojnë vetë sytë me vel,  
disa dielli i jetës i verbon,  
ti grise perden e errët  
dhe bashkove  
hapin me hapin tonë.  
Prapa mbeti errësira.  
Njeriu lind me etjen për dritë.  
Mbyll sytë me etjen për dritë...

# **MOTIVE NGA ZBORI**

\* \* \*

Në këtë ngricë të thellë janari  
veç uniformat tonë gjelbërojnë.  
Shkëmbinjve, që të heshtur na shikojnë,  
u duket se janë kthyer lulet e bari.

Duart që mbajnë tornon ose frezën  
dhe duart, që veç me penën janë mësuar,  
tytën e ftohtë të pushkës kanë shtrënguar,  
ndërsa mbi të thyhen të ndritshme rrezet.

Në vend të diellit, që s'ka forcë të ngrohë,  
sa shumë mund të të ngrohë një buzëqeshje.  
Rrjeshtohemi. Në u dashtë, atdheu në përlleshje  
do të na njoħë.

1969

\* \* \*

Nga çasti në çast mund të bjerë sirena e alarmit.  
Në pritje të shqetësuara shkojnë orët,  
po ja... nga grapi ynë tash çan ajrin  
një këngë gazmore.

Dhe prush të ri i hedh zjarrit të gazit  
e nuk e lë të shuhet sadopak  
e thjeshta, e qeshura  
skuadërkomandante,  
Zana flokëverdha, që ngjan si çunak.

Si fishekzjarre ndizen e ndrijnë  
shakatë.  
Kënga si dallgë, herë ulet, herë ngrihet.  
Kemi përshtypjen se nuk është natë,  
aq shumë ky hovi ynë i zmbrapsi hijet.

Veç ne,  
kundër hijeve të natës  
dimë të hedhim dhe plumbin e rëndë,  
si po hedhim tani  
të qeshura e këngë.

1969

\* \* \*

Presin e presin stilografi i etur  
dhe librat stivë mbi tryezën time.  
Letrat e bardha si jetime mbetur,  
presin të thithin djersë dhe mendime...

Prisni. Do vij sërish te ju të derdh  
përftyrimet, që ndiqen si valë.  
Do vij. Porse vegimi juaj m'u zverdh,  
se tani pushka që shtrëngoj e ka fjalën.

Dhe ndjej se porsi Atllasi i lashtësisë  
tani po mbaj në krahë tërë këtë qiell.  
Këto majë, që agimi zu të ndrisë,  
dhe së shpejti do vij aty t'jua sjell.

1969

**KUR UA MËSOJMË ANTENAVE  
GJUHËN E FSHEHTË**

Në vitet e shkujdesura fëminore  
pata lexuar për një heroizëm të rrallë.  
Ndërlidhësi zgjati linjën mes dëbore,  
pastaj një plumb e kafshoi në ballë.

Dhe ai, ndërsa po zhytej n'errësirë,  
shtrëngoi fort e fort telin ndër dhëmbë.  
Shenjat që vinin gjetën udhë të lirë.  
Edhe i vdekur atdheut i mbeti antenë.

Një vdekje e tillë, vdekje që është fitore,  
sa e bukur do më ngjante, sa e lehtë!  
Të heshtura, tendosim nervat prore,  
antenave t'ua mësojmë gjuhën e fshehtë.

*Maj, 1968.*

## DREJT LARTËSIVE

*Parashutisteve të para*

Si ëndrrat tuaja  
shpalosej kaltërsia  
kur ju me këngë  
nisët fluturimin.

Parashutat u hapën  
si kurorat e luleve në mes të blerimit,  
si zemrat tuaja.

Dhe ju, që patë  
sa i gjerë është horizonti në lartësi,  
menduat  
për shekujt që deshën t'jua mbyllnin  
horizontin në kuti.

(Kanuni t'u hap para sysh, Drane,  
si një hon i zi.

Që poshtë në thellësi  
vinin thirrjet e egra

mbytur nga koha).  
Mbi të fluturonit,  
bebëzat e mbushura  
me gjerësinë e atdheut  
shihnit si zbulonte tërë bukurinë e saj  
toka mëmë.

*Prill, 1968,*

## **RRUGA JOTE**

*Luftëtares së të resë  
Luiza Kaço.*

Ti deshe të ecje me të në një rrugë.

Po rruga jote ishte kaq e gjerë.

Në të kishte rreze të ndritshme, pluhur, gurë,  
duar të shtrënguara, buzëqeshje të ngrohta dhe  
flamurë.

Ajo rrugë  
nuk dredhonte  
asnje herë.

Ti deshe të shikoje...

Kur vije e sillje ngjyrat e botës së gjerë  
e skuqur, e kapitur dhe e gëzuar  
në sytë e tij ti deshe të shikoje

atë zjarr që tē ndizte  
pasqyruar.

Por fjala e tij kumbonte akull — ngrirë:  
«Ç'të duhen ty tē gjitha këto? Je vajzë».  
Si dallgë tē ngruhej peshë shpirti i lirë.  
Mendimi i rreptë  
nga buzët mirrte krahë.  
Dhe atë ditë...  
Një gaz tē madh ti prisje.  
Dhe atë ditë  
vështrimi i tij ashpër tē qe mbërthyer.  
Fjalët e tij ti ndjeve si një krismë.  
Diçka midis jush  
përjetë ishte thyer.

«Për gratë hyrja në Parti ka telashe...»  
A mos këto fjalë do bëheshin gardh,  
që ty tē tē linin  
jashtë radhe?  
Sytë e shokëve t'u shfaqën në atë çast.

Dhe, e menduar,  
e mbështete gjatë  
mbi duar ballin,

59189

13088

ku nxinte një rrudhë.  
Po një vendim t'u poq  
në shpirt atë natë.  
Ti nesër do të mirrje  
tjetër udhë.

Se rruga jote është kaq e gjerë.  
Në të ka rreze të ndritshme, pluhur, gurë,  
duar të shtrënguara, buzëqeshje të ngrohta dhe  
flamurë.

Ajo rrugë  
nuk dredhon  
asnjë herë.

*Korrik, 1969*

## TI NA FLET...

*Mësuesit Ismet Sali Bruçaj*

Ata po presin.  
Në dejt e tij  
ai e ndjen këtë pritje.  
Rruga e gjatë ngjan e shkurtër,  
acari ngrohtësi,  
çlodhje kjo kapitje.  
Në njëren dorë librat,  
në tjetrën një radio,  
udha nuk i duket e rëndë.  
Ata presin,  
~~dhe~~ ai ecën  
i ngarkuar me dritë,  
i ngarkuar me këngë.  
Vërshojnë përrrenjtë e turbullt...  
Mjegull... mjegull...  
po ndizen sytë e fëmijëve t'i ndriçojnë rrugën,

dhe shkon përpara.  
Qielli i murmë rëndon...  
Zëra të dhemshur njerëzish,  
zëri i egër i tufanit  
i thonë të ndalet.  
Ai ecën  
dhe ngjan  
i rreptë si malet.

\* \* \*

Ata po presin.  
Ti ecën... ecën...  
Ti ende flet...  
Vdekja, në mes zërin  
dot s'ta preu.  
Ti flet...  
Dhe fjalën tënde s'e dëgjojnë  
trembëdhjetë fëmijë,  
po gjithë Atdheu.

**4 dhjetor 1968**

## RRUGË TË HAPURA

*... na pasqyrohet  
në sytë plot ndriçim  
e ardhmja që s'është ëndërr,  
po krijim.*

## PËR AZOTIKUN

Nga oxhaqet ngrihen or' e çast re tymi,  
të bardha, të hirta, ngjyrë portokalli,  
si të shumëngjyrëshme mendime.

Në sfondin e kthjellët të qiellit,  
kullat e larta  
synojnë të prekin diellin.

Tubat zgjaten, kryqëzohen, vetëtijnë  
dhe ngjajnë  
rrugë të hapura që ndrijnë.

Nuk mundem  
më asgjë të përshkruaj.  
Nëpër mua, si nëpër një antenë  
kalon kënga e juaj.

*Fier, 20 nëndor 1968*

## KËNGË PËR TEKNOLOGËT<sup>(1)</sup>

Ata të dy janë ngjitur në kulmin e fabrikës,  
si ngjiten trimat,  
në më të lartën majë.  
Ngrihet e ulet niveli i ujit në kaldajë.  
Në zemrat e njerëzve  
ankthi i pritjes.

Vëzhgojnë ata... S'ndjejnë se shkojnë orët,  
se mbi qytet  
ka hapur krahët nata.  
(E hidhur kjo cingërimë dimërore!)  
Dhe era fryn.  
Pastaj shpërthen shtërngata.

Fryn era  
si egërsira që do t'ngulë dhëmbët,  
era që edhe lisat mundet t'i përkulë,  
fryn, sikur t'deshte  
s'andejmi t'i shkulë.

Frym...

Nuk arrin t'u gjejë rrënjet.

Veç për shoku-shokun

ndjejnë shqetësim të vetvetishëm.

«Mbërthe rripin, shok!»

Ngrohen në frymëmarrjen e njëri-tjetrit,  
dhe ndihen të fuqishëm.

Të dy tok.

Qëndrojnë. Largojnë vegimet.

(Një shtrat i butë... një zë i dashur).

Dhe, ndonëse buza nga ngrica u ka plasur,  
ata presin të qetë, në heshtje  
agimin.

Kanë kaluar kështu plot njëzet orë,  
po s'e kanë dhënë veten,  
të kapitur.

Përshëndesin rrezen e parë, të ndritur  
me lodhjen gëzimplotë të fitores.

1969

---

1) Bëhet fjalë për një episod real, për aktin heroik të dy teknologëve të Azotikut të cilët, në mungesë të aparatit për të matur nivelin e ujit në kaldajë, muarën përsipër ta zëvendësonin duke vëzhguar vetë ditë e natë.

## NË ROZAFAT

Nëpër këto frëngji të ngushta,  
prej nga shqiptari  
drejt në ballë  
armikun pat shënuar,  
unë shoh tani  
më qartë,  
se në çdo shekull të shkuar.

E shoh, Rozafë,  
si shtypën rininë tënde  
të rëndët gurë,  
zakoni më i rëndë.

E shoh,  
si rrjedh parreshtur  
nga ata gurë  
një burim heroizmi  
të heshtur,  
E shoh...

\* \* \*

Pranë rreptësisë së gurit,  
këto lule të freskëta kanë çelur  
si këngët  
e kënduara në pushkë mbështetur.  
Krenari e thinjur,  
rini e përhershme,  
ashpërsi,  
ëmbëlsi e pashtershme.

\* \* \*

Legjendat nuk janë të errëta.  
Duke pritur  
që t'i vinte dita,  
shpirti i popullit i mbrujti me ëndrra.  
Në to shkrihen  
errësira e drita.  
Zbres shkallët e gurta.  
Shkoj ku më presin  
të reja beteja,  
dhe ku do të thuren  
legjenda të reja...

*Shkodër, shtator 1968*

## NË UZINËN E TELIT TË BAKRIT

Lëmshet e zjarrta që dalin nga furra  
rendin, kryqëzohen, sërish e nisin udhën,  
ngajnjë si zemra të ndezura, gati për shtegtim,  
si zemrat tuaja, motra, ku shkrin çdo ditë e më  
tepër ndrojtja.

Gjuhën teknike ma bëjnë të kuptueshme  
rrezet e krenarisë, që shkrepin nga sytë tuaj.  
Duke e zhytur e menduar në ata sy aq të thellë,  
shoh në to pasqyruar hijen e moçme të mureve.  
I shoh të ndjekin të përqëndruar fijet e qëndiz-  
mave,

që vërtiten e vërtiten në një botë të ngushtë.

Po hijet e errëta, gjithnjë mbyten në fund  
të syve tuaj të kthjellët, si liqene të qartë,  
ku ndrit tani gjerësia e horizonteve.

Telat mbështillen në bobina, zgjaten në udhë pa  
mbarim.

Dhe dashuria juaj i ndjek hap pas hapi.

Në mendimet tuaja rrjedh drita, që nesër do  
rrjedhë në to.

Në mendimet e mia vërshon jehona e zërit  
që më tha: «Këthehu, këthehu, përsëri!»  
dhe një kupë dashurie e ndjej te buzët,  
një kupë që e pi... e pi...

*Shkodër, shtator 1968*

## **DRITË E RREME**

*(Përshtypje nga ekspozita kundër rolit  
reaksionar të fesë)*

\* \* \*

Ky manikin shenjtori, që i ndrit rroba e purpurt,  
dikur tërhiqte vështrimet me të zjarrtën lutje.  
Me flakën e pishës ngjet — dikur e vetmja dritë,  
që sytë me tym t'i verbonte,  
po prapë e kërkonin në errësirë —  
dhe tani mbetet mënjanë, shkëlqim i venitur dhe i  
**harruar.**

*Shkodër, shtator 1968*

## **DUKE VIZITUAR SHTËPINË E MIGJENIT**

E di. Poetët larg hedhin vështrimin,  
shohin diellin kur ende është errësirë.  
E di. Poetët të parët japid kushtrimin  
se si ajër të thithin duan lirinë.

Me besim të patundur të ardhmen prisje,  
kur mjerimi mbillte farë helmi e lote,  
dhe me zjarr rinor ti brohorisje:  
«Qeshu, rini! Bota është e jote!»

Dhe më nuk shihje si fuqitë të linin,  
se si sëmundja të treti e të zverdhi.  
Ti hidhje sytë në kohët që do vinin  
dhe përshpërisje:... dhe pranvera erdhi...»

Erdhi pranvera, që sytë e tu s'e panë  
veçse në lenten magjike tē këngës.  
(Kënga është shqiponjë, që do qiejt e paanë.  
Kënga nuk duron dot zinxhirë tē rëndë).

Ta ndjej zërin, që koha s'ta ka shuar.  
Na fton tē rendim në shtigjet e paçara,  
atje ku mendja ende s'ka fluturuar,  
na fton tē hedhim sytë gjithnjë përpara.

*Shkodër, shtator 1968*

## **PRANË DRINIT**

\* \* \*

Kjo bukuri e egër e shkëmbinjve,  
dallgë që përpijnë njëra-tjetrën,  
shekuj të largët që shfaqen thellë. . .  
Sytë në sfondin e murmë treten. . .  
Mbi të lumit të moçmen klithmë,  
zëri i sondave dhe i eskavatorëve.  
Rrezëllimet që ende s'kanë lindur  
ndër fytyrat e rrepta të punëtorëve.

*Vau i Dejës, shtator 1968*

**MOTIVE NGA FUSHA**

\* \* \*

Fusha sheh me mijëra sy lule dielli.  
Në prehër të saj erdhëm  
që me natë.  
Këto ditë  
tavan kemi qielin,  
penë e letër  
tokën dhe shatën.

Toka mëmë na ndezi tani  
krahërorin,  
si dashuria e parë.  
Dhe në rrjeshtat e gjelbra të arës  
duam ta shkruajmë  
këtë dashuri.

Kaq barëra t'egra kemi për të shkulur  
nga toka dhe nga vetja  
pa mëshirë,  
që filizi i ri  
më fort të ngulet,

të shpërthejë lule e fletë  
i lirë.

Ndoshta  
djersa rrjedh ballit rrëke,  
ndoshta  
dora e pamësuar mpihet.

Ndoshta... Po askush nuk e vë re.  
Si flamur dielli mbi ne ngrihet...

\* \* \*

Valë-valë të gjelbëra të një deti pambarim,  
në fund të të cilit mund të mbytet plogështia,  
valë-valë të gjelbëra të një deti të çuditshëm,  
ku mund të zhduken rrudhat në shpirt e në  
fytyrë.

Zhytemi më thellë, më thellë. Toka na deh me  
aromë.

Kërkojmë të ndjekim atë këngë që nisin  
fshatarët.

Shata godet ritmikisht mbi tokën e njomë,  
dhe tanë s'jemi veçse valë  
të një deti të përbashkët.

\* \* \*

Si zërin e largët të nënës  
ndjej afër zërin e tokës.

Të gjelbrat, të shpleksurat flokë  
të fushës mbi mua kanë rënë.

Dhe ajri ngjan si prej kristali.  
Në bar t'njomë shoh të ndizen me mijë  
të kuqe, të arta shkëndija,  
dhurata që dielli na fali.

*Rrushkull, korrik 1968*

## GJIROKASTRËS

Ti sigurisht  
kaq lart  
na je ngjitur,  
që syri yt  
atdheun të vështrojë,  
dhë gjoksi yt  
për të të bëhet mburojë.  
Para teje  
unë rri  
si fëmijë e mahnitur.  
Çdo gur i yt  
në zëmër më troket,  
më tërheq në èndërrime  
larg  
nga i qeshuri,  
i bleruari qytet  
i fëminisë sime.  
Armët,  
që gjithënëjë  
ti mbajte ngjeshur,

ditët pa bukë,  
netët pa gjumë  
të lanë ty  
aq kohë pa buzëqeshur,  
të bënë  
të ngrysur  
e të rreptë aq shumë.  
Gurët ligjërojnë  
pa pushim  
për beteja,  
për bijën tënde Argjiro,  
që qëndroi dhe e vetme.  
Dritat, që ndezin  
netët e tua të reja,  
janë sytë e tu,  
që vështrojnë të nesërmen.

\* \* \*

Ndërsa thyheshin  
mbi ty  
dallgët e viteve  
ti lindje bij,  
shkëmbinj të gjallë.

\* \* \*

Koha

të pati lënë dikur  
vështrimzymtë,  
fjalëhidhur  
dhe ngjiteshe ti  
pas gurit,  
shqiponjë  
me krahë të lidhur.

Tani

prehëri yt  
nuk i mban dot  
kaq uzina,  
kaq dritë  
kaq rini  
dhe zgjeron krahët  
or' e çast,  
sot  
të bëhesh gati  
për një fluturim  
të ri.

\* \* \*

Ndërsa

po dal  
nga uzina metalike

dhe ndjej  
                hove t  reja gjall rie,  
t  shoh  
                t  thinjur,  
                koh rash heroike,  
sikur mban  
                tela t argjend  nus rie.

1965-1969

## VËLLEZËRVE TË RËNË

Pranë lapidareve  
kam ardhur që t'ju sjell  
si trëndafil të kuq  
zemrën time.

Pranë lapidareve  
s'ndjeva ftohtësinë e gurit të ri  
që ju ndan nga ne,  
po si valë ndjeva të më përshkojë një  
ngrohtësi.

Ngrohtësia e ëndrrave tuaja qe.

Ëndrrat tuaja  
që s'u varrosën,  
ëndrrat tuaja,  
që si farë  
u mbuallën nën dhe  
për të shpërthyer lule  
çdo pranverë  
tek ne.

*Maj, 1968*

## KËNGË PËR LUFTËN E HESHTUR

*Shokëve të Institutit*

Ndoshta kjo betejë e heshtur me penë e me letër  
s'u ngjan betejave me hekurin a dallgët e egra,  
s'u ngjan betejave me tokën, me gurin, me shkrepat,  
po edhe *këtu* ne shkallmojmë botën e vjetër.

Këtu nuk rrjedh djersa, po-rrymë e trazuar-rrjedhin  
mendimet.

Në thellësinë e shekujve ne zhytemi si palombarë.  
Guacka pa vlerë do nxjerrim a margaritarë?  
S'e dimë, po sa herë, sypafjetur, presim agimet.

1969

\* \* \*

Rridh, o gurrë magjike e poezisë,  
fjalët e thata pér t'i freskuar  
edhe tingujt e argjendtë të së ardhmës,  
fali zërit të kohës së shkuar.

Nëpër xame buzëqesh kaltërsia,  
rreze dielli ma bëjnë me sy.  
E natyrës po m'thotë magjia:  
«Pse nuk vjen? Pse qëndron aty?»

Unë ngre kokën nga libra e fletore:  
«Dijeni, juaja jam kurdoherë  
lule, diell, kaltërsi pranverore,  
po n'mes jush mos më ftoni kët herë,

se këtu kam pér të qëndruar,  
me pishtar'n e mendimit udhrrëfenjës,  
që në pluhurin e kohës së shkuar  
të gjej lulet e gjalla të ndjenjës.

1966

## NË NJË MBLEDHJE

Mbledhja po zgjat këtë mbrëmje shumë.  
Po rrjedhin fjalët si një përrua i rrëmbyer.  
Qepallat shkundin orë e çast gjumin,  
që të gjithë nga folësi sytë kanë kthyer.

Po luftohet sot indiferentizmi,  
kjo perde e hirtë që sytë t'i zë  
dhe, përtej guaskës së vogël  
të egoizmit,  
në botën e gjerë të shohësh nuk të lë.

«Të flasin shokët!»

Një çast... një heshtje e mpirë.  
Dikush murmurit diçka nën buzë.  
Po kaq mjafton akullin për të shkrirë.  
Njëri ngrihet e flet tërë zjarr e shpuzë.

Pastaj të tjerë çohen ngadalë, me radhë.  
Dikush ende ngurron dhe mendohet.

Po edhe druri nuk mund të rrëzohet  
me një të rëne sopate.

Disa ende me mospërfillje tundin kokën,  
disa gërmojnë në ndërgjegjen e tyre,  
po, kur vështrojnë  
në sytë e shokëve,  
më qartë shohin veten në pasqyrë.

Këta sy të japin zjarr, guxim  
të thyesh guaskën që të ka mbështjellë,  
të mbushësh plot me forcë e me besim.  
Sytë e shokëve dëpërtojnë në shpirt thellë.

Dhe marrin vrapin me radhë mendimet,  
si re ngarkuar me shqetësimet e ditës.  
Njëri me tjetrin përplasen me gjëmime.  
Prej tyre lind dritë.

*Nëntor 1968.*

## NË 500-VJETORIN E SKËNDERBEUT

Trokon, trokon parreshtur më pranë kali i  
Gjergjit.  
E neve na duket sikur shtegtojmë nëpër  
shekuj.  
A shkojmë ne tek Ai, a vjen Ai tek ne?  
S'e dimë, veç ja ndjejmë zërin krenari-plot:  
-Sërish u bë Shqipëria pishtar rrezatonjës».

*Janar 1968*

## **KUR SHEH BOTËN NË SYTË E FËMIJËS**

*Nipit tim*

Kur shtrin duart e vogla për të përqafuar  
botën e madhe,  
sytë e tu shkëlqejnë në fytyrëzën e njomë,  
si pikat e vesës mbi petalet e luleve.  
Buzëqeshja jote është si rreze dielli,  
që nuk e di gëzimin që u fal të tjerëve.  
Kur në krahët e mi hidhesh pa pushim,  
kur në ballin e qetë, si deti pa dallgë,  
të sajohen rrudha si të frynte era e mendimit,  
unë e di se digjesh nga padurimi për të jetuar.  
Ty të pret një kohë e bukur dhe e shqetësuar.  
Buzët që s'kanë çelur ende burbuqe fjalësh  
do të thonë fjalë të reja, më të thella se  
tonat...

*Shtator 1968*

**DUKE VËSHTRUAR LULET E PJESHKËS**

Këto lule të çuditshme, si të formuara nga mjegulla  
e trëndafiltë mëngjezore,  
Sa shumë që u ngjasin ëndrrave fëminore.  
Sa prej tyre të vogla, të brishta era ka për t'i  
rrëmbyer  
sa do çelin, do japid frytin e ëmbël, të shkëlqyer.

1969

\* \* \*

S'dua tē t'bëj me krahët e mi  
një rrëth magjik që botën t' zhdukë,  
S'dua gjithshka tē më bësh fli,  
po dua tē t'jap e tē më kthesh zjarr,  
dhe krah për krah, në tē njëjtën rrugë,  
tē ecim bashkë deri në varr.

\* \* \*

Ti më the se ikin fluturim  
çastet pa kthim.

Unë të thashë: Do të kemi të tjera.  
Dashuria do të jetë  
si sot përhera.

Nga gjelbërimi i zhdukur,  
lind tjetri më i bukur.

\* \* \*

## MËNGJEZ DIMRI

Shpirtin ta mbush  
me ëmbëlsi të çuditshme  
kjo buzëqeshje e diellit,  
ndonëse e zbetë.

Turma,  
ngarkuar  
me shqetësimet e përditshme,  
si valë e ngrohtë  
trotuareve derdh jetë.

Si rinia mes thëllimit,  
lart ngrenë kryet  
mimozat  
në këtë ditë të acartë.

Ngjan se pranvera,  
fshehur pas mjegullash  
po na vështron,  
me mijëra sy të artë.

*Shkurt 1968*

## NË LIQENIN E OHRIT

Si një sy i madh,  
i kaltër,  
i dlirë,  
ti pasqyron  
blerim dhe hapësirë.  
Dhe ndoshta  
ke ardhur ti në jetë,  
të njohë atdheu  
bukurinë e vet.

*Pogradec, 1967*

## NËNËS SIME

Nën këngën tënde të ëmbël  
sa herë  
unë, fëmija,  
në gjumë pata rënë.  
Tani e kam radhën unë  
të të këndoja këngë,  
po ti fle tani, e nuk zgjohesh, nënë.

Desha të të këndoja,  
jo për të të vajtuar.  
M'u shfaq e gjallë  
fytyra jote e bukur  
dhe ndjeva mbi ballë  
ledhatuese, dy duar.

Përse rëndoijnë vargjet,  
s'gjen dot udhë mendimi?  
Kjo s'është elegji...  
**Më e ngrohtë se dielli**,  
shpërndan retë e trishtimit  
buzëqeshja jote e kthjellët.

Më shfaqesh  
herë e qeshur,  
herë e menduar,  
herë e rreptë,  
herë e thjeshtë, si fëmijë,  
shtigjet e jetës duke m'i treguar  
mua, që të isha  
motër, shoqe, bijë.

Më ngjan se prapë do të kapemi dorë për dore.  
Do të të tregoja unë shtigje të panjohur  
dhe aty të derdhje atë gjallëri rinoре,  
që koha s' qe e aftë për të ta ftohur.

Ti ike  
udhës së largët, nënë,  
ike e mbështjellë me dritë rinie,  
motrës, shoqes, bijës

duke i lënë  
këngët e pakënduara,  
që me ty s'u tretën,  
dhe dashurinë e pafund për jetën.

*Gusht 1968*

\* \* \*

Me gardh  
përfytyrimet  
dot s'i ndaj.  
Ndjenjën rebele  
s'ka ritëm që e shtron.  
Rreth e përqark bregut,  
i pafaj  
deti vallzon...  
Valët e tua,  
det,  
pi zemra e etshme,  
shqetësimin  
ta thith  
fjala e poezisë,  
o djep i jetës,  
djep i bukurisë,  
o lëvizje e përjetshme!  
Ëmbël në krahë  
më pret  
ti, gazmor.

Trupit e mendjes  
freskinë m'i kthen,  
veçse, kur dua  
të t'shtrëngoj në krahëror,  
m'ikën...  
më kthehesh...  
Prap' ikën,  
prap' vjen.  
Ashtu më ngjet  
dhe me ty,  
Poezi.  
Ëmbël më vjen  
pranë  
me ledhatim  
Vec, kur dua  
të t'shtrëngoj në gji,  
ti, lozonjare  
m'ikën fluturim.

1965

## AUTOBIOGRAFI

Mbi botë tymi i luftës ende krejt s'ishte zhdukur,  
atdheu prej një viti një rrugë të re kish çarë.  
Nëna ime përkulte fytyrën e saj të bukur,  
mbi krevatin e kaltër ku flinte fëmija e parë.

Unë bëja duke u lëkundur hapat e parë në jetë.  
Ngrihesha, rrëzohesha dhe ngrihesha përsëri.  
Atdheu im për herë të parë ecte vetë,  
hidhte hapa viganë në histori.

Fëminia s'm'u përkund nga përralla magjistarësh,  
kur rinia jonë u hapte gjoksin maleve.  
Fëminia mori frymë me ritme pesëvjeçarësh.  
Në rrjeshtat e fletores m'shkrepte drita e hidrocen-  
traleve.

Në sy më pasqyrohej vendi im që po rritej.  
Veten e ndjeja të vogël para botës së madhe,  
dhe veç një gjë mendoja: të rridhnin me vërtik ditët.  
e të vinte ai çast që të vihesha edhe unë në radhë.

Ndër lodrat më përziheshin shqetësimet e shekullit,  
ndaj shpesh përfytyrimet më vraponin larg,  
kërkonin të zbulonin të ardhmen e mjegullt,  
kështu më lindi mua dhe i pari varg.

Të panumërtat qenë shqetësimet që kish Shqipëria,  
rrëqethje të nxehta përshkonin anekënd tokën,  
dhe pranë meje ende shumë motra të mia  
në heshtje, të ndrydhura e ulnin kokën.

Më shkoi fëminia në këtë atmosferë betejash,  
kur dy botë përplaseshin njëra me tjetrën parreshtur.  
Ndjeva në veten time hovin e sa e sa të rejash  
dhe desha të ngre zërin për gjithë shekujt që kemi  
heshtur.

1969

**P O E M A**

## PAMPOSHTMËRI

*Këto ditë  
do të mbeten në qiellin e  
errët të kujtimit si yje të  
shkëlqyera.*

S'janë fenerët e maqinave që çajnë natën,  
janë zemrat e ndezura nga dashuria vllazërore.  
Nga të gjitha anët e atdheut ata kanë ardhur  
dhe çajnë nëpër borë.

\* \* \*

Në krahëror era e dhjetorit të shpon si thikë e  
mprehtë,  
po më fort të shpon thika e dhimbjes së  
vlezërve  
dhe, duke harruar gjumin, bukën, ngrohtësinë  
e vatrës,

rend  
t'ua bësh të lehtë.

\* \* \*

Gërmadhat,  
që tokën kanë mbuluar,  
pasqyrohen  
ndër sy të pikëlluar.  
Mbi ato gërmadha do të bjerë djersa jonë  
si shiu mbi të lashtat e zhuritura  
dhe ato do të rilindin përsëri.  
Nuk është mrekulli.

\* \* \*

Si zogj të shpejtë  
fluturojnë mbi hon  
maqinat e ngarkuara  
me tulla,  
trarë,  
çimento  
e me dashurinë tonë.

\* \* \*

Shpirtvegjëlit,  
skeptikët  
mund të vështrojnë me buzëqeshje ironike,  
kokën  
me mosbesim duke tundur:  
«Brenda një muaji të ngrihen shtëpitë?  
Nuk është e mundur!»  
Zërat e tyre  
humbasin  
në korin e fuqishëm të zërave tanë,  
shkelen  
nga shtëpitë e reja,  
që ngrihen në çdo anë.

\* \* \*

Tullat kalojnë ndër duart e lidhura varg.  
Njëri pas tjetrit  
ngrihen kate.  
Të vijnë ndër mend përrallat e fëminisë,  
për pallatet e ngritura  
brenda një nate.

\* \* \*

Vështron malësori  
shtëpinë që rilind... .

Dikur,  
si ballona letre  
do të ngjiteshin drejt qiellit  
dhe do të biñin poshtë  
lutje të kota.  
Në vetmi  
do gëlltiste hidhërimin,  
dhe do të endej  
si gjeth që e vërtit shqota...  
Dëgjon malësori  
këngën e bashkimit...

\* \* \*

Në këto tulla,  
që ngjeshen fort njëra me tjetrën,  
kanë mbetur thërrime nga shpirti  
i muratorit,  
studentit,  
poetit.  
Dibra është bërë një vatër e madhe,  
ku digjet  
zjarri i solidaritetit.

\* \* \*

Ditë e natë ngjiten  
maqinat

shtigjeve të malit.  
Këto tërthore të akullta  
i kemi shtruar me asfaltin e idealit...

\* \* \*

Yjet nga lart na vështrojnë, si mijëra sy  
të çuditur,  
ndërsa ne derdhemi  
e derdhemi  
porsi shi yjesh  
mbi tokën e cfilitur.

\* \* \*

Ndrijnë nëpër fytyra  
buzëqeshja dhe lotët  
si te ylberi.  
Si rrëqethje gëzimi ndër ëreje,  
përhapet lajmi  
që vjen Enveri.  
Fluturojnë në ajër  
flokët e dëborës,  
si mendime të bardha.  
Dhe vjen Ai  
të ndezë me fjalën e Partisë  
ndërgjegjen  
dhe vatrat.

\* \* \*

Kaq afër dhe kaq larg...

Një piramidë na ndan  
nga vëllezërit.

Hidhërimi i tyre  
kufirin çan  
dhe hyn  
në varg.

Fytyra të dhimbshme,  
trupa që rrëqethen,  
gërmadha,  
gërmadha,  
të vdekur  
e të gjallë që presin  
t'u vijë radha.

Tërbimin e dhjetorit  
s'ka kush ta ndalë,  
ndërsa, për të lidhur  
plagët e gjakosura,  
fjalë,  
fjalë,  
fjalë.

Po jo vetëm dhimbja,  
as thëllimi  
u lë në fytyrë gjurmë,  
po zemërimi...  
Një tërmet tjetër

ka nisur tē zjejë  
nē shpirt tē tyre  
dhe ēshtē gati tē shpērthejē.

\* \* \*

Godisni,  
shokë, mē fort!  
Godisni  
me çekan e me mistri!  
Shtëpia do tē ngrihet lart e fortë,  
e bukur,  
ashtu si deshi ai.  
Së shpejti sytë plot pritje tē fëmijëve  
do shohin mbi çati tē skuqë  
një flamur.  
Dhe nē brohorimën e qindramijëve  
do ta ndjejmë zërin e tij si dikur.  
Godisni  
me çekan e me mistri!  
Kjo t' jetë këngë  
për shokun që la radhët.  
Dhe gruaja  
për atë nuk mbajti zi,  
po erdh tē shtojë  
turmën tonë tē madhe.  
Kjo dhimbja jonë  
nuk na shkrin nē lot,

kjo dhimbja jone  
në gur nuk na kthen,  
kjo dhimbja jone  
na zgjon vrulle plot,  
dhe më të fortë  
dita e re na gjen.

\* \* \*

Këto ditë,  
kur vdekja me jetën,  
dhimbja me gazin  
fort janë mbërthyer,  
këto ditë  
do të mbeten në qielin e errët të kujtimit  
si yje të shkëlqyer.

\* \* \*

Natyra, në egërsi të saj,  
shtëpitë,  
drurët,  
bile edhe malet  
mund të shembë.  
Duke u mbështetur njëri te tjetri  
ne  
qëndrojmë në këmbë.

*Dhjetor 1967*

## **DRITË E NGJYRA TË AKSIONIT**

*Vullnetareve të brigadës  
«17 Nëntori».*

Në këtë çast,  
si lëmojnë valët  
gurët e bardhë në fund të Shkumbinit,  
do desha unë  
t'i lëmoja fjalët.

Mbi urë kujtimesh  
drejt meje ju vini...  
Krahët ju zgjas  
si në çastin e ndarjes.

Dua t' ju rrok,  
t'iu mbaj pranë  
plot mall.

Tash, që si shkëndijat ne jemi shpërndarë,  
dua flakën e atyre ditëve  
të ngjall.

\* \* \*

Agimin presim,  
gatitu  
si ushtarë.  
Flamuri rreh flatrat, si zog që nis fluturimet.  
Ngjitet lart,  
më lart,  
dhe ngjyra e kuqe zjarr  
na mbështjell sytë,  
ndjenjat,  
mendimet.

\* \* \*

Diell,  
kaltërsi  
ndrijnë mbi ne,  
në shallin e aksionit,  
në krahëror.  
Do t'i shtohet ky lumë  
i rrëmbyeshëm rinor  
vrullit të valës  
së thinjur dhe të re.

\* \* \*

Në sheshin e dashur rrjeshtuar,  
rezultatet e ditës  
presim me brohoritje.

Koha duke rendur me vrapin e nxituar,  
nuk do të mund të më zhdukë  
këtë mahnitje,  
për këtë jetë  
ku shpalosen  
këngët dhe flamurët  
më bukur se në të gjitha përfytyrimet e

poezisë,

për duart tuaja, motra,  
që, bashkë me dheun e gurët,  
hedhin  
larg,  
larg  
konceptin e brishtësisë.

\* \* \*

Turni i tretë...

Net që marrin sy  
nga shkëndijat e zemrës vetë.  
Agime

të përshëndetura me të lopatave goditje,  
që shohin  
urën  
dhe ndërgjegjen tonë  
në rritje.

\* \* \*

Këtu zgjerohen krahërorët,  
krahët bëhen të fuqishëm,  
mund të ngrenë lart një botë.  
Ditët këtu fluturojnë si orët,  
si ditë çastet janë kuptimplotë.

\* \* \*

Këtu këngët lindin çdo ditë,  
si lule që farën ua hedh era  
livadheve të njomë.

Është imja, është jotja, nuk dihet, është e të  
gjithëve.

Kur tingëllon në ajër ne themi:  
«kënga jonë».

\* \* \*

Ndërsa duart e buta  
gatuajnjë betonin,  
ndjejmë se shpirtin tonë  
brumos revolucioni.

\* \* \*

Nesër,

kur një fishkëllimë lokomotive  
do ngjajë sikur emrat e shokëve thërret,  
do ndjej sérish emrin e bukur «Rivë»,  
do shoh buzëqeshjen e émbël që flet...

Do shoh sérish

sytë e kaltër, të thellë,  
aq të kulluar,  
si burim mali.

Do ndjej sérish pranë  
vajzën nga Tropoja,  
që kazma në dorë  
s'di t'i pushojë,  
që i ka të pakta fjalët,  
po të qeshurit si argjënd,  
dhe ngjan si lule  
e mbirë mbi shkëmb,  
që dalëngadalë i hap petalet.

\* \* \*

Më qartë se në fotografi  
fytyrat tuaja  
fiksuar më janë në zemër.  
Tek ju kujtoj  
të gjitha, emër për emër,

më shfaqesh edhe ti.  
Të shoh të skuqur,  
të krrusur mbi letër.  
(Vështirë mendimin  
me fjalë për ta veshur).  
Pastaj shoh dritën  
e syve të qeshur.  
Them se poete  
do bëhesh patjetër.

\* \* \*

C'mendon,  
vogëlushe  
flokëderdhur,  
që sytë m'i hedh shpesh  
kureshtare?  
Pas muresh  
mund të ishe zverdhur,  
këto ndjenja të mëdha  
t'mos njihje fare...  
Dhe ti,  
si shoqe të tjera  
t'i bindeshe  
paragjykimit që nxin...  
po akujt e vjetër  
i shkrin  
pranvera.

Patjetër,  
ti do të vije  
në qytetin e madh  
të thithje dije.

Patjetër,  
ti do të 'vije  
këtu,  
ku lartësohet traseja,  
dhe nesër  
do bëhesh një shkëndijë,  
që do ndezë  
zjarre të reja...

\* \* \*

Tek rrëmojmë  
që ura lart të ngrihet,  
ndjejmë të na vijë që larg një oshëtimë.  
Shkumbimi rrjedh i rrëmbyeshëm. Në të shekujt  
rrjedhin. Përzihet  
zhurma e kazmave  
me të shpatave vringëllimë.

\* \* \*

Mbi trungje rrapi jemi ulur.

Përreth  
male.

Lart  
qiell,

dhe sytë të gjitha i kemi ngulur  
në një libër,  
që na tërheq si diell.

Dëgjojmë  
dhe veten e ndjejmë  
të forta,  
krenare,  
si këto male.

Përtërijmë  
ndjenjat e papërshkrueshme  
të shoqeve,  
nëpër mbledhjet ilegale. . .

\* \* \*

Lodhja e kohëve të para  
si vesë u tret.

Malli për shtëpinë — e zbetë dritë.  
Me ndjenja të tjera

i hap sytë.  
Tjetër gjë ndjen,  
kur gjumi  
mbi ty zbret.

\* \* \*

Mbi ankimin e zymtë të shiut  
zërat buçimtare.

Thasët me çimento rëndoijnë mbi krahët e  
njomë.

Rrobet e qullura ngjiten pas trupit,  
po s'duam t'ja dimë.  
Është pasuria jonë.  
Këndoni, motra, më fort:  
«Ne s'trembemi fare...»  
Më kot era shfryn kundër nesh  
si bishë e tërbuar,  
vetëtimat ngjajnë gjarpërinj,  
gati pér të kafshuar.  
Edhe sikur tërë qielli  
mbi ne të vërshojë,  
ne s'tundemi.  
E dimë  
se kush do fitojë.

\* \* \*

Ndjej malin e Vashës të më thotë një legjendë.  
Pér t'ja provuar  
të zjarrtën dashuri,  
një djalë e ngjiti gjer në majë të shtrenjtën,  
vdiq duke e mbajtur  
në krahët e tij.  
Ne do ta ngremë  
mbi krahët tanë rinorë  
atdheun e shtrenjtë  
në majën më të lartë  
dhe nuk do biem...

Ti e di,  
që na fal prorë  
muskuj të hekurt  
dhe vështrim të qartë.

*Xibrakë, qershori 1969 —  
Tiranë, korrik 1969.*

## RRUGA ËSHTË E GJATË

Thonin se ishim të dobëta,  
megjithatë pesha më e rëndë ishte për ne.  
Supet tona gati thyheshin nën këtë peshë.  
(Supet tona ku u mbështet edhe pushka).  
Si burbuqe që s'arrin të shpërthejë  
na fishkej nënqeshja në buzë në agim të rinisë.

\* \* \*

I hapnim sytë në jetë,  
pa përshëndetje gjëzimi.  
Diellin na e zinte hija e rëndë e mureve,  
hija e rëndë e fjalëve.  
Nga bota e madhe  
nuk shihnim veçse një copë të vogël.  
Si ajo copë e vogël  
na ngushtohej zemra,  
na ngushtoheshin mendimet.

Dhe endeshim si hije,  
pa pasur asgjë tonën,  
as emrin,  
pa mundur të krijonim,  
pa mundur të dashuronim,  
pa mundur të mishëronim me fjalë  
atë lëmsh të hidhur në krahëror.  
Jeta rridhte...  
dhe, si shkëndija të mekura  
ndizeshin e shuheshin shpresat për lumturi.

\* \* \*

Tingujt e këmbanave  
na këndonin ninullën monotone:  
«Duro, duro.  
Ke lindur për të vuajtur».  
Dhe flaka e zbetë e qirinjve  
i lbyrte sytë tanë që kërkonin dritë.

\* \* \*

Në kafazet e dritareve  
thërmohoj hapësira.  
Nata,  
e ndarë në mijëra copa të zeza,  
na zbriste mbi fytyrë,

mbi ndjenjat,  
mbi èndrrat,  
vegitmet e ndritura.

\* \* \*

Pranë na ishte toka,  
e rrudhur si ne,  
e tharë si ne,  
e shtypur si ne,  
e fortë si ne,  
si ne nuk lodhej së mbajturi në gjirin  
e pashtershëm jetën.

\* \* \*

Ylber,  
pas shirave të lotëve,  
ishte për ne buzëqeshja e fëmijëve tanë.

\* \* \*

Buzët tona heshtnin,  
po duart tona nuk reshtnin.  
Fjalët e pathëna  
shndërroheshin në lule,

derdheshin në ngjyrat e qëndizmave,  
apo në librin e madh të tokës skaliteshin.

\* \* \*

Shtrydhnim nga gjiri për bijtë  
qumështin e përzier me gjak, që kishte një  
shije të hidhur prej hekuri.  
Bijve në deje gjaku u shndërrohej në hekur.

\* \* \*

Liria, që kurrë s'patëm njojur, na ish aq  
e shtrenjtë,  
në tokën vadir nga djersa e nga lotët,  
aq thellë na ishin ngulur rrënjet  
sa djemve aq herë armët vetë ua patëm  
ngjeshur  
dhe shpesh pranë tyre u rrjeshtuam  
për të mbrojtur këtë truall a pér të vdekur.

\* \* \*

Dhe kur burrat binin,  
duke vadir tokën nënë me gjakun e trimërisë.  
apo larg shtegtonin,  
duke tretur në dhe të huaj lulen e rinisë,

ne qëndronim  
të fundit roje besnike të këtij dheu.  
Mbi krahët tanë të brishtë mbështetej atdheu.

\* \* \*

Kur mbi ne kishte rënë  
pëlhura e zezë e mjerimit,  
ne endnim  
me fijet e arta të ëndrrave  
pëlhirën e agimit.

\* \* \*

Zjarret e pashpërthyera  
shndërrroheshin në këngë.  
Nën valën e atyre këngëve bijt hidhnin shtat.

\* \* \*

Dhe, kur te ne qe pjekur fara e dhimbjes dhe  
e urejtjes,  
rrugën tonë  
na e ndriti shkreptima e lashtë e pushkës  
dhe u gjetëm në radhë.

\* \* \*

Po rrugën  
si dikur nuk e humbëm.

Pranë dritës së hershme  
qe edhe një dritë e re,  
drita e mendimit të urtë kaq gjatë të ndry-  
shur.

e gjakut, djersë dhe lotëve të popullit,  
metamorfozë e shkëlqyer,  
një dritë e kuqe,  
një dritë ngjyrë agimi.

Në atë dritë  
ne pamë atdheun tonë,  
ne pamë veten tonë,  
ne pamë të ardhmen tonë.  
E ndjemë se ishim të forta,  
se duhet të ngriheshim.

U ngritëm...

Më të rënda se plumbat  
binin mbi ne  
fjalët.

Si përbuzje  
të hidhura.

Donin  
të na mbanin të lidhura.

I dogjëm  
në flakën e idealit

\* \* \*

Në netët ilegale  
kur shpërndanim trakte,

na ngjante  
sikur shpérndanim rreze.  
Në shpërgenj të agimit  
ishin shnëdrruar  
të zymtat  
napa të zeza.

\* \* \*

Kur grisnim çarçafët, sikur grisnim errësirën e  
së kaluarës.  
Në rrëzëllimet e zjarreve partizane shihnim  
ditë të tjera.

\* \* \*

Ne ecnim pranë vëllezërve.  
Me butësi motre u lidhним plagët.  
Me urrejtje të dyfishtë hapnim zjarr mbi  
armikun.  
Për herë të parë këndonim me gjithë zë  
këngë të reja, që flisnin për një jetë njerëzore.

\* \* \*

Kur rrugës  
mbulonim me dhe  
një pjesë të zemrës sonë,  
një pjesë të gjakut tonë,  
**pa fjalë;**  
pa lotë  
**ruthnim në ballë tifin a bijën;**  
**U rrëmbenim pushkën.**  
**Vazhdonim udhën.**

\* \* \*

Nuk të harrojmë, Bule,  
ti ishe e njomë, si filizat e pranverës,  
ti ishe e gurtë, si qyteti që të lindi.  
Kur të hodhën ty litarin,  
malet, muret, kalldrëmet  
ndjenë se ju muar fryma.  
Kur të hodhën ty litarin,  
rrapi i lashtë, shkëmbenjtë e njerëzit  
ndrisnin ende te vështrimi yt.  
Ata e shtrëngonin litarin më fort  
e dridheshin,  
se ndjenin vetë  
lakun në fyt.

\* \* \*

Nuk të harrojmë, Margaritë,  
nga një kohë e palindur të vinte ajo kthjelltësi  
në zë,  
nga gjokset tonë merrje fjalën që peshë të ngre.  
**Perden e mjegullt të viteve zhbirin bebzat**  
**plot drithë...**

\* \* \*

**Si dallgë deti,**  
që s'mund të jetë kurrë e qetë,  
të shohim, Zonjë,  
që në ballë të çetës rend përjetë.

\* \* \*

Rruja jonë  
u njom me pika gjaku.  
Çdo pikë e gjakut tonë  
shndërrohej në një yll të kuq  
që na tregonte shtigjet.

\* \* \*

Dhe erdhi dita, erdhi,  
kur mijëra yjet tanë të kuq

u shkrinë në një diell të madh  
e ky diell,  
flakë i kuq,  
nga gjaku ynë  
u ngjit në horizont.  
Dhe ne morëm frymë,  
sikur na u hoq nga gjoksi  
një shkëmb,  
që me shekuj mbi të kish rënduar,  
po nuk u ndalëm,  
se rruga jonë  
porsa kishte filluar.

Ende drejt nesh  
zgjaste dorën e kaluara.  
Ja ndjenim zërin e ngjirur të tmerrshëm:  
«Kthehu prapa!»  
Ajo përpiqej të na lidhte pas saj,  
duke na hedhur mbi supe  
tërkuzën,  
kanunin,  
pluhurin e fesë.  
Dhe, nganjëherë,  
dhe krisma armësh.  
(Mos harroni Martën e Prenën,

mos harroni natën e errët të prillit,  
kur ato vdiqën si ushtarë në këmbë,  
duke pohuar gjer në frymën e fundit idealin  
e tyre.

(Kujtimi i tyre  
le të na derdhë vrull ndër rremba  
kur ngadalësojmë hapin.)

\* \* \*

S'ngopeshim  
duke mësuar,  
si i burgosuri i liruar  
s'ngopet me dritë e hapësirë.  
Duke lëvizur lapsin mbi letër,  
sikur godisnim  
shekujt,  
që na lanë në errësirë.

\* \* \*

Me duart tonë,  
krah për krah me vëllezërit  
derdhëm hekur  
në rrembat e Shqipërisë,  
me duart tonë

i kthyem rininë tokës,  
ua rrëmbyem dritën dallgëve,  
endëm për atdheun  
një rrobë diellore.

Çuditëm  
veten  
dhe të tjerët  
me forcën vigane  
fshehur në duart e njoma,  
po në rrugën tonë prisnin  
shumë shtigje,  
që s'qenë çarë akoma.

\* \* \*

Në mes të luleve të ditëve të reja  
kanuni përgjonte si gjarpër i zi,  
i gatshëm për të na kafshuar.  
Dhe ende shumë nga ne kërrusnin shpinën  
nën barrën e rëndë të poshtërimit.  
Dashurinë s'guxonin ta shihnin në fytyrë,  
jetën s'guxonin ta shihnin në fytyrë,  
në mes të luleve të ditëve të reja  
(një copë errësirë  
ende të pagrisur nga plumbat e nëntorit,  
mbi të cilën ra rrufe zhuritëse  
6 shkurti).

Po më e vështirë qe të pritej nga rrënjet  
druri i helmatisur shekullor i mosbesimit,  
që na kishte lënë gjithnjë në hije.

\* \* \*

(Hijen e tij vigane  
e shoh të bjerë tani mbi këtë fletë.  
Dhe ngre kundër saj  
si Zonja Çurre pushkën,  
si Shkurta lopatën,  
penën.  
Të mundte ajo të nxirrte në çast shkëndija,  
të zhdukej krejt hija.)

\* \* \*

Është beteja më e rëndë,  
beteja pa armë,  
beteja e mendimeve  
edhe me të shtrenjtit e tu,  
edhe me veten tënde.

\* \* \*

S'është e lehtë  
të largosh dorën e padukshme që të  
mbështetet mbi buzë

kur do ta thuash fjalën tënde.

S'është e lehtë

të hedhësh prapa krahëve shekuj të tërë,  
në mënyrë që gjurmët e lëna në jetë  
të mos u ngjasin gjurmëve që lë vala mbi rërë.  
Tani s'të godasin me plumba,  
as me fjalë të rënda,  
po me buzëqeshje ironike,  
me vështrime mospërfillëse.

Gardhet e padukshme kapërcehen më vështirë  
dhe është e zorshme të ecësh përpara,  
po më e hidhur të ndalesh  
kur do të jesh e lirë.

\* \* \*

Rruja është e gjatë.

Duke vështruar

të shkuarën, që na ra nga supet e cfilitur,  
themi:

«Sa shumë kemi arritur».

Po, duke vështruar

së largu majën e ndritur,  
themi:

«Sa pak kemi arritur».

\* \* \*

Ecim ndër të përpjeta.

Shpesh një botë në agoni

na hap përpara  
një greminë.

Na merren mendtë një çast...

Po e kapërcejmë

Derdhemi fushave,  
ngjitemi maleve,  
deri në qiellin e atdheut,  
prej nga shikojmë  
shekujt që shkuan  
dhe shekujt që do vijnë.

\* \* \*

Kemi kaluar ndër kohëra  
të heshtura si toka,  
të fuqishme si toka,  
jetëdhënëse si toka,  
si toka kemi fshehur thellë në gjirin tonë  
mijëra burime që prisnin veç rastin për  
shpërthim.

\* \* \*

Burimet po shpërthejnë...  
Nën ato valë  
të varrosim thellë çdo ngurrim.

Të ecim  
vetëm përpara.  
Nëse do të biem,  
të biem në fluturim.

\* \* \*

Dikur veç dyqind<sup>(1)</sup>  
me zjarrin e mendimit të qartë  
errësirën e grisën.  
Sot dyqind vajzat,<sup>(2)</sup>  
që një shtegëtim të ri nisën,  
u mësojnë motrave  
një këngë krejt të re:  
«Shtëpia jonë  
është kudo të jetë atdhe».

\* \* \*

Si vërshojnë në një dhomë të mbyllur  
dielli dhe era e lirë,  
në ëndrrat tonë  
hyri aq hapësirë.

---

1) 200 komunistët e parë.

2) Është fjala për 200 vajzat korçare që shkuan të punojnë në Kombinatin e Tekstilit «Mao Ce Dun» në Berat.

Ne, që ëndërronim  
veç një shkëndizë lumturie të vogël,  
tani ëndërrojmë  
dhe digjemi  
për zjarrin e lumturisë  
të gjithë botës.

\* \* \*

Ashtu si na shkojnë netët,  
kryet mbi djep përkulur,  
duke përgjuar  
çdo rrahje qepalle të fëmijës,  
ashtu  
sa agime na gjetën,  
duke përgjuar  
me shqetësim prej nëne  
lëvizjet e maqinës,  
apo me vështrimin  
në faqe librash ngulur,  
që si fëmijët  
të lindim,  
të rrisim  
vepra për atdhe,  
që mbi krahët tanë  
të ngremë lart si foshnjën  
një botë të re.

\* \* \*

Nga kumbimi i hapit tonë të sigurt  
do të shuhet jehona  
e fjalëve përbuzëse:  
«Aq ja pret! Është grua»,  
dhe do të marrim gjithnjë ngajeta ku tërë  
rrugët janë tonat,  
të drejtën më të lartë:  
të drejtën për të krijuar.

\* \* \*

Më s'do ta fshehim dashurinë  
kur ta ndjejmë në zemër,  
do ta shpalosim  
nën qiellin tonë të pastër,  
dhe dashuria për ne ka veç një emër:  
luftë e përbashkët.

\* \* \*

Nga gëzimet e mëdha që na premton koha  
një gëzim shumë të madh do të ndjejmë prorë:  
neve na takon të mbajmë në gji të ardhmen,  
të ardhmen me sy të kulluar fëminorë.

Duke u mësuar bijve se si në ndërtesën që  
ngrihet lart,  
me duart e tyre të shtojnë nga një gur,  
nuk harrojmë t'u mësojmë zanatin e lashtë të  
pushkës  
dhe gati jemi ta shtrëngojmë pér t'i mbrojtur  
si dikur.

\* \* \*

U bëmë aq të forta,  
e përsëri  
mund të gëzohemi pér një lule a një flutur.  
Prapë dimë të përkëdhelim,  
të mallëngjehemi  
dhe më thellë kuptojmë  
sejeta është e bukur.

\* \* \*

Duke ecur rrugës,  
shkundim pluhurin e thashethemeve,  
shqetësimëve të vogla  
që na kishte mbështjellë.  
Na zgjerohet krahërori.  
Marrim frymë më thellë.

\* \* \*

Rruga është e gjatë.  
Duhet ta shohim qartë.  
Pas një maje na pret  
një tjetër më e lartë.

\* \* \*

Po afrohet dita  
që gjoksin do t'ua kthejmë gjithë erërave  
të jetës  
duke mbajtur ballin lart, krah për krah me  
vëllezërit,  
që fjalët «nuk mundem»  
do të dergjen nën pluhur,  
si relike muzeumi.  
Dhe ne atëhere  
do të jemi shndërruar në drita,  
që të shohin udhën e tyre,  
thellë ndër mote,  
gratë e gjithë botës.

1968-1969

Në mëngjezin e asaj dite dielli lindi flakë i kuq  
në horizontin e vrejtur.

Në mëngjezin e asaj dite dielli pikonte gjak,  
gjaku i një populli dyfish të tradhëtuar.

Në mëngjezin e asaj dite ra një shi i rrëmbyer.

Po s'ishte shi ai: pikonin lot,

lotët e hidhur të një populli zënë në befasi.

Në mëngjezin e asaj dite dallgët e detit ngriheshin  
lart,

dhe unë e dija se ishte zemërimi i shenjtë i një  
populli.

Në mëngjezin e asaj dite shtatëmbëdhjetëvjeçarja  
nga Bratisllava,

dha tërë ditët që ende s'i kish jetuar,  
tërë ëndrrat që ende s'i kish ëndërruar,

dashurinë që s'e kish ndjerë,

veprat që s'i kish krijuar.

Në mëngjezin e asaj dite,  
nëpër antenat urrejtja

nga gjokset tuaja  
kalonte në gjokse të tjera...  
Në mëngjezin e asaj dite  
drita u fundos në errësirë,  
dhe në mes të gushtit  
u veshën me akull muret, udhët e zemrat.  
Hija e kryqit të thyer  
u shfaq nën yllin e kuq.

\* \* \*

Mbi gjokset tuaj pesha e tankeve,  
kujtimi i Fuçikut,  
ironia e hidhur e fjalëve:  
«Kemi ardhur për t'ju çliruar si në dyzetepe-  
sën.»  
Mbi gjokset tanë pesha e dhimbjes suaj.

\* \* \*

Dhe u drodhët,  
sikur nën këmbët tuaja  
u hap papritur një humnerë.  
«Si vallë kemi qenë aq të verbër?»  
Rrugët ngjanin si plagë,

udhëheqësit tuaj përqafoheshin me ujquit  
e Kremlinit.

Toka klithte për shpagë.

\* \* \*

Po zjarri i madh  
Kur do të ndizet vallë ?  
Dhe, që të ngrihet lart flaka,  
Jan Palashi  
vuri  
trupin e tij të gjallë.

\* \* \*

Në ballin tuaj  
ku s'numérohen rrudhat,  
shket si hije drite  
vegimi  
i një dite,  
kur nga eshtrat e të rënëve  
do të mbijnë thika për të huajt,  
kur yllin e kuq të zhgërryer në pluhur  
do ta pastroni  
me gjakun tuaj.

1968-69

## BISÉDË ME LEXUESIT

Rri e mendoj  
duke ju përfytyruar  
me orë.  
Poezi,  
vallë  
çfarë do të thotë?  
Poeti  
te një lule  
sheh një botë,  
dhe botën  
si një lule  
mban në dorë.  
Dhe ju,  
që me duart e fuqishme  
do prekni  
një ditë  
këto fletë,

mund t'më qortoni,  
se mblodha shumë pak rreze  
nga jeta jonë  
e pasur dhe e larmishme.  
Të mbledhësh rreze?  
Po drita që lëshon,  
atëhere  
si e hënës  
do jetë  
e zbetë.

Të mbledhësh rreze,  
e di që nuk mjafton.

Që t'japësh dritë  
duhet të digjesh vetë.

Ende shumë pak  
u njoh njerëzve gaz e brengë.

Ende shumë pyetjeve  
nuk di t'u përgjigjem.

Vetëm një gjë di tani:  
të digjem,

e si bleta me nektar  
t'mbushem me këngë.

Po si gjurmë në zall  
humbshin këngët e mia,  
në qoftë se  
nga ju do jem shkëputur,

në më verboftë me dritë  
lavdia  
dhe në u sjellsha rrëth saj  
porsi flutur.

1969

## PASQYRË E LËNDËS

### ZJARRE DHE VRULLË

Faqe

Duke kërkuar dritën .....	5
---------------------------	---

### MOTIVE NGA ZBORI

Në këtë ngricë të thellë janari .....	9
Nga çasti në çast mund të bjerë sirena e alarmit .....	10
Presin e presin stilografi i etur .....	12
Kur ua mësojmë antenave gjuhën e fshehtë .....	13
Drejt lartësive .....	14
Rruga jote .....	16
Ti na flet.....	19

### RRUGË TË HAPURA

Për Azotikun .....	23
Këngë për teknologët .....	24

## MOTIVE SHKODRANE

Në Rozafat .....	29
Në uzinën e telit të bakrit .....	31
Dritë e rreme .....	33
Duke vizituar shtëpinë e Migjenit .....	34
Pranë Drinit .....	36

## MOTIVE NGA FUSHA

Gjirokastrës .....	42
Vëllezërve të rënë .....	46
Këngë për luftën e heshtur .....	47
Rridh, o gurrë magjike e poezisë.. .	48
Në një mbledhje .....	49
Në 500-vjetorin e Skënderbeut .....	51

## PETALE LULESHP

Kur sheh botën në sytë e fëmijës .....	55
Duke vështruar lulet e pjeshkës .....	56
S'dua të t'bëj me krahët e mi .....	57
Ti më the se ikin fluturim .....	58
Sytë e tu janë për mua aq të thellë.. .	59
Mëngjez dimri .....	60
Në liqenin e Ohrit. ....	61

Faqë

Nënës sime .....	62
Me gardh përfytyrimet dot s'i ndaj.....	65
Autobiografi .....	67

P O E M A

Pamposhtmëri.....	71
Dritë e ngjyra të aksionit .....	79
Rruge është e gjatë .....	89

FLAKË NËPËR RRUZULL

21 gusht.....	109
Bisedë me lexuesit .....	112